



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 165/2 prot

Datë 31.01.2022

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Olsi” SHPK & “Bolv Oil” SHA në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-15926-12-21-2021 me objekt “*Blerje Karburanti*”, me fond limit 9,097,221 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.01.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
- Ankimues:** BOE “Olsi” SHPK & “Bolv Oil” SHA  
*Adresa: Patos, Fier.*
- Autoriteti Kontraktor:** Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor  
*Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, nr. 8, Tiranë.*

Në datën 27.01.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë elektronike në Sistemin e Ankesave Elektronike ankesa me nr. A/2022/1821, protokolluar me nr. 165, datë 28.01.2022, e BOE “Olsi” SHPK & “Bolv Oil” SHA për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-15926-12-21-2021 me objekt “*Blerje Karburanti*”, me fond limit 9,097,221 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.01.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Olsi” SHPK & “Bolv Oil” SHA.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin*

*e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që BOE “Olsi” SHPK & “Bolv Oil” SHA kundërshton me anë të ankesës me nr. A/2022/1821, datë 27.01.2022, protokolluar me nr. 165, datë 28.01.2022.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

*“Operatori ekonomik nuk ka sjell akt pronësie ose kontrat qeraje përsa i përket aksit rrugor Tiranë – Krujë dhe Gjirokastër – Këlcyrë.*

*Në deklaratën e furnizimit operatori ekonomik nuk është shprehur për të 3 (tre) pikat e sipër cituara. Gjë e cila është kërkuar nga autoriteti kontraktor për tu përmbushur nga operatori ekonomik duke u shprehur në deklaratën e sipër cituar.*

*Në deklaratën e furnizimit operatori ekonomik nuk është shprehur për të 2 (dy) pikat e sipër cituara. Gjë e cila është kërkuar nga autoriteti kontraktor për tu përmbushur nga operatori ekonomik.*

*Operatori ekonomik "Olsi" shpk ka deklaruar dhe vërtetuar nëpërmjet kontratës së bashkëpunimit se vjen si bashkim operatorësh me “Bolv Oil” sh.a, dhe në rastet e bashkimit të operatorëve, secili anëtar duhet të paraqes vetëdeklarimin për përmbushjen e detyrimeve. Ky operator ekonomik, “Bolv Oil” sh.a nuk ka paraqitur vetëdeklarimin e sipër përmendur”*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 31.01.2022.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**